



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 2/840

Datë: 15/10/2019

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më datën 14.10.2019, mori

**V E N D I M**

*Për plotësim të Vendimit nr. 2/706, dt. 26.9.2019 për vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit të diplomimit për studentët të cilët e kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së rregullt të studimeve në nivelin baçelor, master dhe doktoratë, sipas kushteve në vijim:*


1. Pika XI e vendimit nr. 2/706, dt. 26.9.2019, ndryshohet si në vijim:  
XI. Studentëve të nivelit baçelor dhe master që kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit, mirëpo nuk i kanë përfunduar të gjitha provimet e vitit të fundit në programet që studimet përfundojnë me mbrojtje të temës, ndërsa fakulteti përkatës nuk i ofron këto studime me programe të reja studimore, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më dt. 30.9.2020.
2. Pika XII e vendimit nr. 2/706, dt. 26.9.2019, ndryshohet si në vijim:  
XII. Studentëve të tjerë të nivelit të studimeve baçelor dhe master të cilët e kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së studimeve të rregullta për vit studimi, ndërsa aktualisht janë në vitin e parë (I), dytë (II), tretë (III), katërt (IV) apo pestë (V), por që nuk kanë përfunduar provimet sipas kushteve të përcaktuara në pikat I deri X të këtij vendimi, u mundësohet vazhdimi i studimeve sipas plan-programit të ri të studimeve pa pasur nevojë aplikimi përmes konkursit publik.
3. Pikët tjera të vendimit nr. 2/706, dt. 26.9.2019 mbesin të pandryshuara.

**Arsyetim**

Bazuar në kërkesën dekanëve të disa njësive akademike, për definimin e statusit të të gjitha kategorive të studentëve që kanë kaluar dyfishin e rregullt të kohëzgjatjes së studimeve, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve të njësive akademike;
3. Sekretarëve të njësive akademike;
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
5. Për publikim në ueb-faqe.



REKTORI

Prof. dr. Marjan Dema

*[Signature]*